

# Premtime elektorale

**BASHKË  
FITOJMË**



# *Bujqësia* NË DUART E TUA



## LEDINA ALOLLI

Voto  
1

- Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural.
- Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
- Tregjet dhe marketingu i produkteve bujqësore dhe ushqimore.
- Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.
- Rritja e kapaciteteve të industrisë agro-përpunuese dhe konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore për eksport
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe mbrojtja e biodiversitetit



## **Bujqesi dhe zhvillimi rural**

- **Përmirësimi dhe rritja** e standardeve të infrastrukturës së ruajtjes dhe tregtimit të tregut të “Fruta-Perimeve” me shumicë dhe pakicë.
- **Krijimi i tregjeve të gjelbërta** sipas zonave administrative.
- **Disiplinimi** i tregtimit të produkteve blegtorale dhe të peshkut.
- **Promovim** i produkteve bujqësore dhe blegtorale nëpërmjet panairove dhe financim për pjesëmarrje në panairot rajonale dhe kombëtare.
- **Krijimi i urave lidhëse** midis fermerëve me kompani të vendit dhe të huaja serioze të tregtimit apo përpunimit të produkteve bujqësore në lehtësimin e tregtimit të produkteve të tyre.
- **Zbatimi i një skeme para-blerje** për produktet bujqësore nga fermerët duke i siguruar të ardhura atyre por edhe produkte ushqimore cilësore Bashkisë për t'u përdorur në mensat kolektive/sociale, konvikte që menaxhohen nga ajo dhe për të ndihmuar shtresat në nevojë.
- **Përgjysmim i tarifës** për ujitjen e tokave bujqësore.
- **Menaxhim** dhe disiplinim i ujitjes dhe kullimit.
- **Rritjen e kapaciteteve** të mjeteve dhe krijimi i një strukture ndihmëse efikase për pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve ujitëse dhe kanaleve kulluese, të transferuar për administrim nga bashkia.
- **Mbështetje** për rritjen e kapaciteteve përpunuese të frutave dhe perimeve.
- **Mbështetje për marketimin** dhe **certifikimin** e produkteve rajonale, produktet blegtorale, bimët mjekësore etj, “*Made in Albania/Korça*”, duke mbështetur fermerët financiarisht për analizimin dhe certifikimin e produkteve të tyre sipas standardeve për të stimuluar eksportin e tyre.
- **Krijimi i sistemit të informacionit** për administrimin dhe përdorimin e tokës mbështetur në teknologji bashkëkohore.
- **Mbështetja** për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe të resurseve të tjera mjedisore.
- **Kontroll** dhe **monitorim** të territorit (tokës, ujit, ajrit) në funksion të mbrojtjes së mjedisit nga ndotjet për të garantuar produkte bujqësore brenda standardeve të BE.
- **Plani** i mbrojtjes dhe menaxhimit të biodiversitetit.
- **Organizimi i fermerëve** (shoqëri fermerësh) në bazë të fqinjësisë në tokë, me qëllim të konsolidimit të tokës bujqësore.



**LEDINA  
ALOLLI**

- **Do të ngrihet dhe fuqizohet** një strukturë administrative në organigramën e Bashkisë që emërtohet si Drejtoria e Bujqësisë.

# 1 zgjidhje

E MADHE PËR KORÇËN

**MADE IN KORÇA:**  
Cikli “Prodhim, Tregtim, Konsumim”



Historia e Korçës është e lidhur ngushtë me bujqësinë. Ai që quhet ‘zhvillim i qëndrueshëm’ nuk mund të kuptohet pa një bujqësi që ka, jo vetëm tokën, mjetet, krahun e punës, ekspertizën por edhe tregun fundor, duke mbyllur ciklin kërkesë-ofertë. Fermeri korçar ka qenë vazhdimisht i penalizuar nga mungesa e kërkesës për prodhimet e tij të një cilësie të lartë. Kjo

mungesë oferte vjen nga kostoja shumë e lartë e prodhimeve bujqësore korçare, si pasojë e mossubvencionimit nga qeveria. Për pasojë fermeri ynë konkurohet nga prodhimet e rajonit, që janë 4-5 herë më të mbështetura nga shteti. Gjithashtu një rol të rëndësishëm luan krijimi i monopoleve në tregtimin e produkteve bujqësore të importit që zotërohen nga



eksponentë të qeverisë.

Me pak fjalë ky dështim i fermerit korçar ka ardhur nga politikat e gabuara, në rang kombëtar dhe lokal.

“Zgjidhja ime e Madhe për Korçën” është krijimi i një tregu të përbashkët rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar për prodhimet “Made in Korça”, i cili garanton lehtësi dhe mbështetje në prodhim, shitje dhe riqarkullim të produkteve në një treg familjar, fleksibël dhe miqësor me prodhuesin e vogël dhe të mesëm.

dhe, me çmime konkurruese, duke financuar diferencat aty ku ka mospajtime në çmime, siguron tregun për të gjithë prodhimin e rajonit të fermerit të mesëm dhe të madh.

#### **C. BASHKIA KRIJON NJË TREG**

**AGRO-KULTUROR RAJONAL** shumicë/ pakicë për t'i shëryer fermerëve të vegjël dhe prodhimeve të tyre stinore dhe ndërstinore. Ne synojmë ta pastrojmë segmentin Korçë-Pogradec nga tezatqat e prodhimeve bujqësore, të cilat



Me anë të një analize të saktë statistikore dhe cilësore ne kemi bërë një peshim të nevojave të rajonit të Korçës për prodhimin e sektorit agro-kulturor dhe, bazuar në volumin total të këtij prodhimi do të llogarisim edhe tepricat. Plani im është si vijon:

**A. BASHKIA GJEN TREG** vendas/ të huaj për prodhimin agro-kulturor të trevës

**B. BASHKIA IDENTIFIKON** të gjithë aktorët vendas në industrinë e lehtë të përpunimit

rrezikojnë jo vetëm sigurinë fizike të fermerit korçar, por edhe shëndetin e konsumatorit, duke qenë se tregtimi ndodh përtej çdo kriteri sanitaro-higjienik.

#### **D. NE DO TË KRIJOJMË NJË TASK FORCE**

për të gjitha pikat e mësipërme, e cila do të jetë pjesë e organikës së Nënkryetarit për Fshatin, Agro-Kulturën dhe Mbrojtjen e Prodhuetit/ Konsumatorit



Disa nga pikat e paketës fiskale për Bashkinë Korçë.

<https://fb.watch/ku15PRDQSH/>

# 1 zgjidhje

## E MADHE PËR KORÇËN

### NGA SLOGANI 'NË DUART E TUA' TE KALIMI I PUSHTETIT NË DUART E TUA

Në 16 vite pushteti të Rilindjes, ju jeni mësuar me politikanë që bëjnë fushatë me premtime

bukur e radhës. Sot dua t'ju dëshmoj se slogani im nuk është një frazë boshe, që merr fund kur mbaron fushata elektorale. Për këtë kam ideuar një shpërndarje të pushtetit, duke e kaluar nga zyrat pompoze dhe distante të institucioneve në duart tuaja,



- NËNKRYETARË TË DEDIKUAR PËR SEKTORËT KYÇ
- DREJTORI PËR KOMUNITETIN ROM & EGJIPTIAN
- REFERENDUM LOKAL PËR NISMAT E BASHKISË

të mëdha dhe slogane bombastike. Fasada ka bërë që të humbisni besimin. Për këtë shkak, një pjese nga ju, edhe slogani ynë "Korça në duart e tua" iu duket si fraza e

duke bërë këtë me prova dhe me vullnetin e dikujt që beson te bashkëqeverisja me bashkëqytetarët, dhe jo me një grup të mbyllur miqsh e familjarësh.



## 5. DREJTORI PËR KOMUNITETIN ROM/EGJIPTIAN

Komuniteti rom është pjesë e pandarë e jetës së Korçës dhe trevës së saj. Megjithëse në këtë qytet fizikisht, ata kanë qenë jashtë jetës politike, sociale dhe kulturore të tij. Politika dhe pushteti janë kujtuar për komunitetin rom dhe egjiptian vetëm në kohë zgjedhjesh për t'u kërkuar votën dhe për t'i harruar më pas të

## 6. REFERENDUM LOKAL PËR NISMAT E BASHKISË

Për të ndryshuar një formë arbitrare, personale dhe klanore të ushtrimit të pushtetit në bashkinë tonë, ku janë bërë disa investime të cilat kanë shterrur financat e Bashkisë dhe kanë shfytëruar qytetin tonë, duke lënë shije të keqe në komunitet, unë si kryetare e Bashkisë, çdo nismë që ka të bëjë direkt me jetën e komunitetit dhe shihet si vendim i madh dhe



- NËNKRYETARË TË DEDIKUAR PËR SEKTORËT KYÇ
- DREJTORI PËR KOMUNITETIN ROM & EGJIPTIAN
- REFERENDUM LOKAL PËR NISMAT E BASHKISË

nesërmen e zgjedhjeve, deri në zgjedhjet e radhës. Unë dua ta ndryshoj këtë realitet dhe për këtë kam ideuar Drejtorinë e Komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Korçës. Drejtues i saj do të jetë një përfaqësues i komunitetit. Romët dhe egjiptianët do të kenë njeriun e tyre në pushtetin lokal dhe zyrën e posaçme, ku do të drejtohen jo vetëm për të gjetur zgjidhje, por edhe për të patur një zë në punët publike të qytetit.

jetësor për zhvillimin e Korçës, dhe ndeshet me kritika të argumentuara-jo inate politike, do ta paraqes për miratim me votë në referendum. Nuk mund të përsëriten më vendime si ai i kullës së qytetit, që nuk shërben për asgjë, shndërrimi i vendeve të kultit dhe trashëgimisë në zyra të pushtetit, apo prishja dhe shndërrimi tregtar i hapësirave të përbashkëta të Korçës. Vendimet që prekin Korçën, duhet të merren nga korçarët, jo në Tiranë, jo nga një grusht i mbyllur njerëzish.



Korça nuk është e atyre pak individëve që e kanë kthyer në pronë private qytetin, dhe mendojnë që mund të bëjnë ç'të duan. Korça është e juaja. Ju jeni aksionerët e një prej qyteteve më të bukura të Shqipërisë, me një kulturë dhe traditë që i përket Rilindjes së atdhetarëve korçarë, jo "rilindjes socialiste". Për këtë qëllim unë do të krijoj disa zyra ekskluzive në Bashki, dhe disa koncepte qeverisjeje lokale që kanë në thelb parimin e bashkëqeverisjes, të Korçës së qytetarëve, për qytetarët.

politikë që ka lidhje me komunitetin, do të humbasë përfundimisht ai shkëlqim që e ka bërë Korçën të dallojë nga çdo qytet tjetër i vendit. Ne e respektojmë traditën, dhe do t'i qëndrojmë fort idesë se traditën e qytetit e mundësojnë të rinjtë e çdo epoke të saj.

## 2. NËNKRYETAR PËR ARSIMIN, SPORTET DHE KULTURËN

Një prej nënkryetarëve të mi do të merret posaçërisht me problemet dhe zgjidhjet



- NËNKRYETARË TË DEDIKUAR PËR SEKTORËT KYÇ
- DREJTORI PËR KOMUNITETIN ROM & EGJIPTIAN
- REFERENDUM LOKAL PËR NISMAT E BASHKISË

## 1. NËNKRYETAR PËR RININË

Përparësia jonë, duhet dhe do të jetë Rinia korçare, angazhimi i saj në jetën publike, përfshirja në vendimmarrje, rigjenerimi i kapaciteteve të saj. Pa një Rini që merr në duar politikat e të ardhmes së qytetit, pa meritokraci dhe pjesëmarrje, nuk mund të kemi një Korçë moderne që ofron alternativë zhvillimi dhe jetese. Pa një Rini që është pjesë e konceptimit të qytetit, që ushqen me dashuri dhe entuziazëm çdo nismë dhe

e arsimit, sporteve dhe kulturës. Në të gjitha këto fusha, Korça ka qenë e njohur ndër breza, por ka ardhur koha për një rikonceptim kulturor dhe menaxherial, sepse kemi parë në 16 vite, që çdo investim në këto fusha, të jetë për interesa të vogla, që nuk ndikojnë realisht te jeta e komunitetit. Ne na takon përgjegjësia për të sjellë ndryshimin, që Korça të ruajë dhe të rikthejë shkëlqimin kulturor dhe historinë sportive, por gjithashtu të bëhet një qendër e arsimit kombëtar, siç kanë qenë përgjatë viteve.



3 maj 2023

## Arsim

KARTA E STUDENTIT REALITET PREJ FILLIMIT TË VITIT TË RI AKADEMIK!

Studentët janë burimi ku ushqehet e ardhmja e secilit prej nesh! Ndaj investimi më i mirë që mund të bëjmë, është t'i rritim vlerën studentëve tanë. Karta e studentit, me të gjitha mundësitë dhe shërbimet e ofruara nga Bashkia Korçë për studentët tanë, do të jetë realitet që vitin e ardhshëm akademik!



Ledina Alolli

May 3 at 12:43 PM · 🌐



KARTA E STUDENTIT REALITET PREJ FILLIMIT TË VITIT TË RI AKADEMIK!

Studentët janë burimi ku ushqehet e ardhmja e secilit prej nesh! Ndaj investimi më i mirë që mund të bëjmë, është t'i rritim vlerën studentëve tanë. Karta e studentit, me të gjitha mundësitë dhe shërbimet e ofruara nga Bashkia Korçë për studentët tanë, do të jetë realitet që vitin e ardhshëm akademik!

[#LedinaAlolli](#) [#Voto1](#)

*Korça* **LEDINA**  
NË DUART E TUA **ALOLLI** **1**



2 maj 2023

## Infrastruktura

Termoizolim dhe zgjidhje përfundimtare e ngrohjes së banesave për çdo shtëpi private dhe apartament në Korçë!



Ledina Alolli

May 2 at 10:16 PM · 🌐



Projekti ynë është që të hapni derën e shtëpisë dhe të gjeni një ambient të ngrohtë, pa kosto, siç duhet të jetë çdo vatër familjare!

Termoizolim dhe zgjidhje përfundimtare e ngrohjes së banesave për çdo shtëpi private dhe apartament në Korçë!

[#LedinaAlolli](#) [#Voto1](#)



**29 prill 2023**

### **Arsim**

Programi për arsimin do të mbështetet në katër shtylla kryesore:

- Arsim me infrastrukturë bashkëkohore.
- Arsim me përmbajtje cilësore.
- Arsim i mirëpajisur me logjistikë dhe teknologji bashkëkohore.
- Arsim i sigurt dhe gjithëpërfshirës.



Ledina Alolli

April 29 at 3:12 PM · 🌐



Edukimi është një borxh që ua kemi brezave të ardhshëm. Për arsimin nuk duhet të kursehet asnjëherë.

Investimi për arsimin është detyrim për shoqërinë dhe të ardhmen e fëmijëve tanë. Me ndryshimin që duam të sjellim në Bashkinë Korçë, arsimi është prioritet dhe mision thelbësor!

Programi për arsimin do të mbështetet në katër shtylla kryesore:

- Arsim me infrastrukturë bashkëkohore.
- Arsim me përmbajtje cilësore.
- Arsim i mirëpajisur me logjistikë dhe teknologji bashkëkohore.
- Arsim i sigurt dhe gjithëpërfshirës.

#LedinaAlolli #Voto1 #BashkëFitojmë



**27 prill 2023**

### **Infrastruktura**

Pas datës 14 maj fillon përmirësimi dhe ndërhyrja në infrastrukturën problematike në të gjitha rrugët e njësive administrative.



Ledina Alolli

April 27 at 10:27 AM · 🌐



Mjafton një shenjë e vogël nga qielli, pak shi që lag rrugët rurale, dhe dalin në dritë të metat e kësaj Bashkie: rrugët me gropa, të lëna pas dore, që vështirësojnë çdo ditë jetën e banorëve të njësive administrative, njësoj si rasti i rrugës Polenë - Dërsnik!

Pas datës 14 maj fillon përmirësimi dhe ndërhyrja në infrastrukturën problematike në të gjitha rrugët e njësive administrative.

[#LedinaAlolli](#) [#Voto1](#) [#BashkëFitojmë](#)



**20 prill 2023**

### **Infrastruktura**

Me të ndryshuar drejtimin e Bashkisë Korçë, një nga hapat e parë që do të ndërmarrim, është që të ngremë një strehëz publike me veterinerë që do të kujdesen për kafshët endacake dhe ku çdo qytetar mund të sjellë ushqim dhe të përkujdeset për ta!



Ledina Alolli

April 20 at 12:15 PM · 🌐



Të zhgënjyerit në Korçën tonë janë edhe qentë endacakë, të lënë në mëshirë të fatit dhe të destinuar të jenë një kërcënim i vazhdueshëm për fëmijët dhe banorët e qytetit.

Të gjitha kërkesat dhe rastet flagrante janë dërguar kohë pas kohe në Bashki dhe reagimi i vetëm ka qenë indiferenca dhe mungesa e ndërhyrjes!

Me të ndryshuar drejtimin e Bashkisë Korçë, një nga hapat e parë që do të ndërmarrim, është që të ngremë një strehëz publike me veterinerë që do të kujdesen për kafshët endacake dhe ku çdo qytetar mund të sjellë ushqim dhe të përkujdeset për ta!

Qytetërimi i një komuniteti reflektohet edhe nga mënyra si kujdesemi për këto kafshë të braktisura!

Për një drejtim ndryshe,  
Bashkë fitojmë!

#LedinaAlolli 1

#BashkëFitojmë 1



**18 prill 2023**

### **Sherbime sociale**

- Do të promovojmë çdo organizatë dhe nismë vullnetare që do të ofrojë shërbime mbështetëse dhe shërbime shtesë për të moshuarit. Kështu, synojmë të ofrojmë mbështetjen dhe ndihmën në shtëpi, për të moshuarit që jetojnë vetëm ose i kanë fëmijët apo të afërmit e tjerë në emigrim;
- Shërbimet bashkiake për kategorinë e të moshuarve do të mbulohen nga punonjës të Bashkisë që do të shkojnë deri në shtëpitë e të moshuarve, për të kryer veprimet e ndryshme, duke zgjeruar

shërbimin e mbështetjes institucionale të Bashkisë;

- Do të ngremë "Qendrat e moshës", në bashkëpunim me bizneset private në qytet, të cilët përkundrejt lehtësimit nga detyrimet bashkiake, do të ofrojnë në mënyrë të vazhduar vakte ditore dhe kafe për të moshuarit që do të frekuentojnë këto qendra;



Ledina Alolli

April 18 at 10:26 AM · 🌐



Qyteti i Korçës prej kohësh i ka harruar të moshuarit, pensionistët, njerëzit që vërtet mund të ecin më ngadalë se të rinjtë, por kanë përvojë dhe e njohin rrugën ku duhet shkuar, më mirë se kushdo tjetër!

Programi im ka në qendër mbështetjen e kësaj kategorie, duke forcuar rrjetin e shërbimeve dhe duke i kushtuar vëmendje kryesore vështirësive ekonomike të të moshuarve. Plakja e popullsisë është një kusht i ri social me të cilin duhet të përballemi: reagimi fillon duke rritur zërin e buxhetit për të moshuarit në Bashkinë tonë.

- Do të promovojmë çdo organizatë dhe nismë vullnetare që do të ofrojë shërbime mbështetëse dhe shërbime shtesë për të moshuarit. Kështu, synojmë të ofrojmë mbështetjen dhe ndihmën në shtëpi, për të moshuarit që jetojnë vetëm ose i kanë fëmijët apo të afërmit e tjerë në emigrim;
- Shërbimet bashkiake për kategorinë e të moshuarve do të mbulohen nga punonjës të Bashkisë që do të shkojnë deri në shtëpitë e të moshuarve, për të kryer veprimet e ndryshme, duke zgjeruar shërbimin e mbështetjes institucionale të Bashkisë;
- Do të ngremë "Qendrat e moshës", në bashkëpunim me bizneset private në qytet, të cilët përkundrejt lehtësimit nga detyrimet bashkiake, do të ofrojnë në mënyrë të vazhduar vakte ditore dhe kafe për të moshuarit që do të frekuentojnë këto qendra;

Do të bëjmë gjithçka që të moshuarit të vlerësohen si duhet dhe të trajtohen si një pasuri e çmuar e jetës sonë, jo si njerëz që institucioni i Bashkisë kujtohet që janë gjallë, vetëm në fushatat zgjedhore dhe votimet e qytetit!

#LedinaAlolli 1

#BashkëFitojmë 1



Revision #3

Created 2023-05-12 14:16:33 UTC by E. T.

Updated 2023-09-19 11:45:56 UTC by E. T.